



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.195/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova - kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 13.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.195/2025, e datës 11.10.2025, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me dt.12.10.2025.

A r s y e t i m

Me datë 11.10.2025, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se më datë 10.10.2025 është publikuar një video në rrjetet sociale ku shihet një qen endacak në një hapësirë publike në Skenderaj, i ngjyrosur në trup me inicialet "VV" në ngjyrë të kuqe, duke shtuar se ky veprim përbën një akt të dëmshëm ndaj kafshëve, dhe njëkohësisht shfrytëzimi i simboleve politike në kohë të fushatës zgjedhore. Në ankesë theksohet se duke marrë parasysh se në komunën e Skenderajt gara zhvillohet ndërmjet Lëvizjes Vetëvendosje dhe Partisë Demokratike të Kosovës, dhe simboli "VV" i është lyer një kafshe në mënyrë degraduese, ekziston dyshimi i arsyeshëm se veprimi është ndërmarrë nga përkrahësit e PDK-së, për ta dëmtuar imazhin e LVV-së në opinionin publik. Në ankesë theksohet se ky veprim është në kundërshtim me nenin 34 të LZP-së Nr.08/L-228.

Si provë kanë bashkëngjitur video.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka theksuar se ankesa është e pabazuar për faktin se video e paraqitur nuk përmban asnjë dëshmi mbi datën

e xhirimit, prandaj nuk mund të vërtetohet nëse është bërë brenda afatit ligjor, nuk ka asnjë provë që tregon se videoja është realizuar nga anëtarët e PDK-së, po ashtu se nuk ofrohet asnjë dëshmi që vërteton se videoja është xhiruar në Skenderaj. Në bazë të lartcekurave kanë kërkuar nga PZAP që ta refuzojë ankesën si të pabazuar.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës me saktësisht ankesës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik, Partia Demokratike e Kosovës, vlerësoj subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje, si pale ankuese më asnjë provë nuk ka arritur ta argumentoj faktin që videoja e ofruar si dëshmi nga LVV është bërë nga subjekti politik PDK, video incizimi nuk ka datë se kur është bërë, në mënyrë që të vërtetohet afatshmëria, e po ashtu ankuesi nuk ka dhëna vendin përkatësisht adresën e sakte se ku është bërë video incizimi.

Në mungesë të provave konkrete për të dëshmuar që videoja e dorëzuar si provë është bërë nga PDK, datës dhe vendit apo lokacionit të saktë, paneli ka vlerësuar që nuk mund të nxirret përfundimi për shkelje nga neni 34 i LZP-së Nr.08/L-228, andaj vlerësoi se ankesa është e pabazuar.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.195/2025 datë 13.10.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshillë Juridike: *Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes pranimi të këtij vendimi.*